

L I G J
Nr.9018, datë 6.3.2003

**PËR MBLEDHJEN E ARMËVE, TË MUNICIONEVE DHE MATERIALEVE TË TJERA
LUFTARAKE**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj ka si objekt dorëzimin vullnetar, regjistrimin dhe mbledhjen e armëve, municioneve dhe materialeve të tjera luftarake, që mbahen pa leje, si dhe masat shtrënguese që merren për zbatimin e tij.

Neni 2

Parimet e procesit të mbledhjes së armëve

Procesi i mbledhjes së armëve bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe synon, në bashkëpunim me shoqërinë civile, donatorët dhe me organizmat ndërkombëtarë, sensibilizimin e opinionit për krijimin e një shoqërie pa armë dhe dhunë.

KREU II

**STRUKTURAT SHTETËRORE PËR MBLEDHJEN
E ARMËVE DHE DETYRAT**

Neni 3

Komisioni ndërministror i mbledhjes së armëve

1. Për të realizuar procesin e mbledhjes së armëve në Republikën e Shqipërisë krijohet komisioni ndërministror i mbledhjes së armëve me këtë përbërje:

- Zëvendëskryeministri- Kryetar
- Ministri i Rendit Publik - Zëvendëskryetar
- Ministri i Drejtësisë- anëtar
- Ministri i Mbrojtjes- anëtar
- Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit - anëtar
- Kryetari i SHISH-it- anëtar

2. Ministria e Rendit Publik ngarkohet me detyrën e sekretariatit të komisionit ndërministror të mbledhjes së armëve dhe i jep këtij komisioni të gjithë mbështetjen infrastrukturore dhe profesionale. Komisioni ndërministror i mbledhjes së armëve mund të kërkojë ndihmë edhe nga specialistë të ministrive të tjera të paparashikuara në këtë ligj.

Neni 4

Detyrat e komisionit ndërministror të mbledhjes së armëve

1. Komisioni ndërministor i mbledhjes së armëve ndjek në vazhdimësi procesin e mbledhjes së armëve, bazuar në të dhënat e sjella nga Ministri i Rendit Publik, Ministri i Mbrojtjes e Prokurori i Përgjithshëm dhe, jo më pak se një herë në tre muaj, analizon punën e bërë dhe raporton me shkrim përpara Këshillit të Ministrave.

2. Komisioni ndërministor i mbledhjes së armëve, në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor, strukturat e Forcave të Armatosura, organizatat jofitimprurëse dhe ato ndërkombëtare organizon fushata mbarëkombëtare dhe vendore për sensibilizimin publik ose veprimtari të tjera për dorëzimin vullnetar të armëve, municioneve dhe materialeve të tjera luftarake.

3. Komisioni merr vendime për mbarëvajtjen e procesit të mbledhjes së armëve nga strukturat e njohura me këtë ligj.

Neni 5

Komisionet e qarqeve për mbledhjen e armëve dhe detyrat e tyre

Pranë çdo qarku krijohet komisioni i qarkut për mbledhjen e armëve me këtë përbërje:

- prefektikryetar
- kryetari i këshillit të qarkut zëvendëskryetar
- drejtori i policisë së qarkut anëtar
- komandantët e njësive ushtarake anëtarë.

2. Komisioni i qarkut ndjek në vazhdimësi procesin e mbledhjes së armëve, të municioneve dhe materialeve të tjera luftarake dhe, jo më pak se një herë në muaj, raporton pranë komisionit ndërministor të mbledhjes së armëve.

3. Komisioni i qarkut bashkëpunon me të gjitha organizmat ndërkombëtarë ose shoqërinë civile, të përfshira në procesin e mbledhjes së armëve, të autorizuar nga komisioni ndërministor i mbledhjes së armëve.

4. Komisioni i qarkut, në bashkëpunim me komisionet vendore dhe policinë, përcakton grafikun e shkeljes së terrenit nga struktura e policisë së mbledhjes së armëve.

Neni 6

Komisionet vendore të mbledhjes së armëve

1. Komisionet e qarqeve të mbledhjes së armëve, nisur nga shtrirja dhe problemet që duhet të përballojnë në procesin e mbledhjes së armëve, krijojnë komisionet vendore të mbledhjes së armëve pranë rretheve, bashkive dhe komunave, nën juridiksionin e qarkut që mbulohet prej tyre.

2. Komisionet vendore bashkëpunojnë me të gjithë organizmat ndërkombëtarë ose shoqërinë civile, të përfshirë në procesin e mbledhjes së armëve, të autorizuar nga komisioni ndërministor i mbledhjes së armëve.

Neni 7

Struktura e policisë së mbledhjes së armëve

1. Për mbledhjen e armëve krijohen, në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit në Ministrinë e Rendit Publik, strukturat e policisë së mbledhjes së armëve.

2. Ministri i Rendit Publik miraton strukturat për mbledhjen dhe regjistrimin e armëve, të municioneve dhe materialeve të tjera luftarake, sipas niveleve të organizimit të Policisë së Shtetit. Limiti i numrit të punonjësve të këtyre strukturave miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Struktura e policisë së mbledhjes së armëve është pjesë përbërëse e Policisë së Shtetit dhe gëzon të gjitha të drejtat e detyrimit që rrjedhin nga ligji nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit".

4. Kjo strukturë ka detyrë mbledhjen e armëve, të municioneve dhe materialeve të tjera luftarake, që dorëzohen vullnetarisht, si dhe regjistrimin e tyre.

5. Për mbledhjen e armëve, të municioneve dhe materialeve të tjera luftarake, struktura e policisë së mbledhjes të armëve bashkëpunon edhe me sektorë të tjerë të Policisë së Shtetit, pavarësisht nga funksionimi i kësaj strukture.

KREU III DORËZIMI VULLNETAR

Neni 8 **Dorëzimi vullnetar**

1. Me dorëzim vullnetar të armëve, të municioneve dhe materialeve të tjera luftarake kuptohet shprehja e vullnetit të lirë me shkrim dhe dorëzimi në organet e policisë vendore ose organet e pushtetit vendor të armëve, të municioneve dhe materialeve të tjera luftarake, që mbahen pa leje.

2. Struktura e policisë së mbledhjes së armëve, me marrjen e të dhënave për vendndodhjen e armëve, i tërheq ato në bazë të procedurave përkatëse.

3. Personi që shpreh vullnetin për ta dorëzuar armën dhe dëshiron anonimin, e dorëzon atë në vende publike, të ngritura nga policia, pa bërë deklarinimin përkatës.

Neni 9 **Bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes**

Ministria e Rendit Publik dorëzon armët, municionet dhe materialet e tjera luftarake, të mbledhura nga Policia e Shtetit, së bashku me dokumentacionin përkatës, në njësitë ushtarake të përcaktuara më parë nga Ministria e Mbrojtjes.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 10 **Hartimi i strategjisë kombëtare për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta**

Komisioni ndërministror i mbledhjes së armëve, në bashkëpunim me të gjitha organet shtetërore, që bëjnë pjesë në këtë komision, brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, harton strategjinë kombëtare për kontrollin e armëve të vogla e të lehta, e cila shqyrtohet dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 11 **Nxjerrja e akteve nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në zbatim të neneve 7 e 10 të këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore dhe, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të caktojë fondet e nevojshme për përballimin e shpenzimeve që lindin nga zbatimi i këtij ligji.

Neni 12 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3763, datë 27.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**